

DEPARTAMENTI I SHKENCAVE JURIDIKE

Përgjegjës departamenti: Dr. Ismail TAFANI

Departamenti i Shkencave Juridike ju paraqet veprimtarinë kërkimore - shkencore që ka planifikuar të organizojë për vitin akademik 2017 – 2018:

1. Zhvillimin e Konferencës së 4-të Shkencore Ndërkombëtare “*Problemet dhe Sfidat e Transformimit të Shoqërisë Shqiptare drejt Standarteve të Bashkimit Europian*”. Kjo konferencë është planifikuar të organizohet në rang Fakulteti, në 1 Dhjetor 2017. Departamenti i Shkencave Juridike, si bashkë-organizator së bashku me departamentet e tjera të këtij Fakulteti në organizimin e këtij aktiviteti, ka ftuar të gjithë stafin akademik të angazhuar pranë departamentit, për të marrë pjesë në këtë konferencë me punimet e tyre.¹
2. Në fokus të Departamentit të Shkencave Juridike është gjithashtu nxitja e stafit akademik efektiv dhe stafit akademik me kontrate për të botuar në revista të ndryshme shkencore ndërkombëtare ashtu edhe në revista kombëtare e më konkretisht në revistën e Albanian University “Optime”. Gjithashtu pjesmarrja e stafit akademik në aktivitete shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare do të jetë në fokus të kërkesave të Departamentit.
3. Në vazhdim të ndjekjes së traditës në zhvillimin e konferencës studentore, edhe në vitin akademik 2017-2018, Departamenti i Shkencave Juridike do të organizojë konferencën studentore me temë “*Sistemi i drejtësisë në shqipëri, ndarja dhe kontrolli reciprok i pushteteve dhe integrimi i vendit në Bashkimin Europian*”

¹

Ky aktivitet ka si qëllim aktivizimin e studentëve në aktivitetet ekstrakurrikulare dhe impenjimin e tyre drejt kërkimit shkencor në mënyrë që ata të motivohen më shumë gjatë karrierës së tyre Universitare.

Ky aktivitet, fizikisht do të organizohet në një nga sallat në godinën e universitetit, ku zhvillojnë mësimin Programet e Studimit të ofruara në Departamentin e Shkencave Juridike, me qëllim lehtësimin e pjesëmarrjes në aktivitet të studentëve të cilët studjojnë në një nga programet e këtij Departamenti. Aktiviteti do të vendosë në qendër studentët të cilët me referimet e tyre do të jenë përballë një auditori i cili përbëhet nga kolegët e tyre si edhe nga pedagogët e Departamentit, në mënyrë me temat që ata kanë përzgjedhur të trajtojnë të esaurojnë çdo pyetje që do t'u drejtohet nga ky auditor i gjërë.

Lidhur me kostot financiare të institucionit në organizimin e këtij aktiviteti ato janë:

4. Organizimi i leksioneve të hapura është bërë tashmë traditë për departamentin e Shkencave juridike. Edhe këtë vit akademik ashtu si çdo vit tjetër departamenti do të organizojë leksione të hapura duke ftuar në auditoret tona personalitete të shquara në fushën e drejtësisë. Këto aktivitete ekstra-kurrikulare shihen nga Departamenti i Shkencave Juridike si shumë të rëndësishme për plotësimin e dijeve që vijnë si pasojë e zbatimit në praktikë të kurrikulës.